



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 679/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit me Nr.REF-80415-07-24-2018 me objekt: “Blerje aparatura per Cath-Lab (reparti i Kardio-hemodinamikes) dhe poltrona, shtrat vizite etj per Kemio Terapi”, Loti 2, me fond limit limit 20.604.000 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar ne daten 03.09.2018 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.”

Ankimues:

“Farma Net” sh.p.k
Rruga “Siri Kodra”, Nr. 8/660, Tiranë

Autoriteti kontraktor:

Spitali Rajonal Fier,
Lagja “1Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”, Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.07.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-80415-07-24-2018 me objekt: “Blerje aparatura per Cath-Lab (reparti i Kardio-hemodinamikes) dhe poltrona, shtrat vizite etj per Kemio Terapi”, Loti 2, me fond limit limit 20.604.000 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar ne daten 03.09.2018 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

II.2. Në datën 30.07.2018 operatori ekonomik “Farma Net” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm.

II.3. Në datën 06.08.2018, nëpërmjet shkresës nr. 2285/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke mos e pranuar ankesën.

II.4. Në datën 09.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar si vijon:

“I) Në kriteret e vecanta të kualifikimit, konkretisht pika 2.3.9 autoriteti ka kërkuar:

2.3.9 “Kërkohen të paraqiten mostra per artikujt me nr. 1/ECO Kadiake, 3/ Shtrat pacienti me dyshekm, 8/ Crush Cart, 14/ Poltrona Kimioterapie . Dorësimi i Kampioneve/mostrave të bëhet pranë sekretarisë se Spitalit Rajonal Fier deri në 1 orë perpra hapjes së procedurës, të mbyllura me ngjitëse në zarf /a ose kuti transparente të vulosur/a, mbi te cilen/at te shenohet: Mos e hapni me përjashtim të rasteve ku është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit

«.....» dhe jo para datës _____, ora _____. – së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe të firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Mbi cdo mostër të dorëzuar ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).

- Në pakëtimin e cdo mostre duhet të evidentohet origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca1). Nëse mostrat e dorëzuara nuk janë të shoqeruara me listën e inventarizimit dhe të indentifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të cmimit, nese ka mungesa mostrash për artikujt e vecantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet”.

VO: Kriteri për paraqitjen e mostrave vendoset nga autoriteti kontraktor, duke u nisur nga rendesia e vecante që kanë artikujt e kërkuar në funksionimin e repartit të hemodinamikes. Gjithashtu ky kriter vendoset me qëllim realizimin në kohë sa më të shpejtë dhe me cilësi të këtij prokurimi, pasi vetë shërbimi që ofron reparti i hemodinamikës dhe kemioterapisë janë të një rëndesie jetike për qytetarët”.

Ky kriter i vendosur nga AK është tërësisht në kundërshtim me parimet e përgjithshme të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pasi ky kriter është diskriminues, i cili nuk garanton konkurrencën dhe barazinë ndërmjet operatoreve ekonomike por përkundrazi favorizon subjektet e caktuara, duke paragjykuar dhe paracaktuar fituesin e kësaj procedure.

Konkretisht, kërkesa e AK, për dorëzimin e mostrave bazohet në nenin 27 pika 6 germa “a” e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatoreve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ashtu sic kuptohet qartë nga leximi literal i kësaj pikë të VKM-së, kërkesa për dorëzimin e mostrave është një kërkesë që bëhet në ndihmë të vlerësimit të ofertës teknike. Pra, është një opsion shtesë që i vjen në ndihmë KVO-së për të vlerësuar ofertën teknike. Në rastin konkret nuk e kuptojmë se si “doresimi i mostrave” do të ndihmojë KVO-në e kësaj procedure për të vlerësuar ofertat teknike. Në fund të fundit askush nga anëtarët e KVO-së nuk mund të vlerësojë me sy të lirë nëse mostrat e ofertuara janë apo jo në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara pasi keto specifikime janë mjaft komplekse.

Sqarojmë këtu se edhe nese këto mostra do të dorëzohen, ato janë aparatura që duhen montuar /instaluar, programuar etj ... për të gjykuar për funksionimin dhe me tej për programet, parametrat.

Në cdo rast vlerësimi për përmbushjen apo jo të specifikimeve teknike, origjinën, fabrikën prodhuese etj ... do të bëhen bazuar në katalogët përkatës të secilit produkt, si dhe dokumenteve të tjerë të kërkuara.

Pra për të gjykuar nëse një ofertë është kokruese do te mjaftonin midis të tjerave “autorizimi i prodhuesit”, licenca për tregtim të pajisjeve mjekësore, “certifikime mbi sigurimin e cilësisë ISO, deklaratë komformiteti për direktivën e aplikueshme CE “si dhe katalogu përkatës ashtu si me të drejtë ju keni kërkuar

[...] Pra, përfundimisht kuptohet se kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor për dorëzimin e mostrave dhe specifikisht vetëm ato mostra që kanë një vlerë të konsiderueshme (50% e fondit limit), është vendosur qëllimisht për të shmangur konkurrencën dhe barazinë duke favorizuar subjekte të caktuara si dhe duke diskriminuar konkurrentet e tjerë pasi :

- Dorëzimi i mostres nuk ndihmon në vlerësimin e KVO-se, pasi në përfundim do të gjykohej vetëm mbi katalogun e objektit .
- Koha në dispozicion sipas DST (30ditë) është mjaftueshme për të sjelle mallin nga cdo prodhues dhe ndikon në vlerësimin e ofertes (mjafton marreveshja me prodhuesin)

[...]Kërkojmë modifikimin e DST te kesaj procedure prokuruese duke hequr pikën 2.3.9 të "Specifikimeve teknike", si kriter vlerësimi .

II.5. Në datën 20.08.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1379/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2323/1 prot., datë 16.08.2018, me objekt: “Dërgim Informacioni” drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik, Tiranë, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik Public Health Sector

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: “Kërkohen të paraqiten mostra për artikujt me nr.1/ECO Kadiake, 3/ Shtrat pacienti me dyshekm, 8/ Crush Cart, 14/ Poltrona Kimioterapie. Dorësimi i Kampioneve/mostrave të behet pranë sekretarisë së Spitalit Rajonal Fier deri në 1 orë përpara hapjes së procedurës , të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti transparente të vulosura, mbi të cilën/at të shenohet: Mos e hapni me përjashtim të rasteve ku është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës _____, ora ____ . – së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe të firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Mbi cdo mostër të dorëzuar ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).

- Në paketimin e cdo mostre duhet të evidentohet origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca1). Nëse mostrat e dorëzuara nuk

janë të shoqeruara me listën e inventarizimit dhe të indentifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të cimit, nese ka mangesa mostrash për artikujt e vecantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet. [...]Kërkojmë modifikimin e DST te kesaj procedure prokuruese duke hequr pikën 2.3.9 të “Specifikimeve teknike”, si kriter vlerësimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9/1, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, i dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)
- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 ose ISO 13485 (ose ekuivalentet e tyre), të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, të përkthyer dhe të noterizuar.
- 2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 (ose ekuivalentet e tyre) për import eksport, tregtim të materialeve mjekësore. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme, të përkthyer dhe të noterizuar.
- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuara.
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese për tregtimin e artikujve të ofruar. (të përkthyer dhe të noterizuar)
- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.
- 2.3.7 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë) sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.)
- 2.3.8 Deklarate per permbushjen e afatit te garancise. Garancia jo me e vogel se nje vit ku perfishihet mirembajtja, zevendesimi i pajisjes ose i pjeseve te defektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale te cilat do te sigurohen operatori ekonomik fitues me shpenzimet e veta.
- 2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për artikujt me nr.1/ ECHO Kardiake, 3/ Shtrat pacienti me dyshek, 8/ Crush Cart, 14/ Poltrona kimioterapie. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë sekretarise se Spitalit Rajonal Fier deri ne 1 orpara hapjes se procedures, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para datës _____, ora _____. - Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
 - Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).
 - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1). Nëse mostrat e dorëzuara,

nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

VO: Kriteri për paraqitjen e mostrave vendoset nga Autoriteti Kontraktor duke u nisur nga rëndësia e vecante që kanë artikujt e kërkuar në funksionimin e repartit të hemodinamikes. Gjithashtu ky kriter vendoset me qëllim realizimin në kohë sa më të shpejte dhe me çilesi të këtij prokurimi pasi vete shërbimi që ofron reparti i hemodinamikes dhe kemioterapise janë të një rëndësie jetike për qytetaret.

III.1.2. Në shtojcën 1/1 të dokumentave të tenderit është kërkuar:

Formulari i ofertës ekonomike (lot II)

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7	8
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia/ Cope	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Kompania prodhuese	Vendi i origjines	Afati
1	ECHO Kardiake	1					
2	Monitor pacienti	4					
3	Shtrat pacienti me dyshek	4					
4	Shiringa Elektrike	4					
5	Shiringe Kontrasti me dy koka	1					
6	Raft Inoxi	4					
7	Trolley mjeksor	1					
8	Crush Cart	1					
9	Tavoline instrumentash	1					
10	Defibrilator	1					
11	EKG 12 KANALE	2					
12	Perparese plumbi	4					
13	Barelë Urgjence	1					
14	Poltrona kimioterapie	4					
15	Ndarese 3 pjeseshe	2					
16	Blerje Stativa	4					
Çmimi Neto)							
TVSH (%)							
Çmimi Total							

III.1.3. Në shtojcën 10 “*Specifikimet teknike*”, të dokumentave të tenderit, lidhur me pajisjet për të cilat kërkohet të paraqiten mostra, është parashikuar si vijon:

1.Eko Kardiake

- *Ekodopler me ngjyra per peraplikime Gjinekologjike, Obstetrike, Abdominale, Kardiake, Vaskulare, Urologjike etj.*
- *Frekuencat e funksionimit sistemit: 1 deri ne 20 MHz*
- *Mbi 196.000 kanaledixhitaleprocesimi*
- *Te mundesoje ekzaminime Elastografie*
- *Te kete te pakten 4 porta per sonda aktive.*
- *Pajisur me bateri te integruar per autonomi operimi ne mungese te energjise elektrike.*
- *Menyrat e operimit: 2D, 3D, 4D*
- *Monitor me ngjyra (LCD/LED). Madhesia e ekranit mbi 21”, me rezolucion te larte.*
- *Paneli i kontrollit me ekran (LCD/LED) me prekje, per kontroll funksional. Madhesia: mbi 10" diagonal*
- *Shfaqja e imazhit: single/dual/quad, me 256 nuanca grije.*
- *Intervali Dinamik maksimal mbi 250 dB*
- *Thellesia e fushes se skanimit: min. 0-40 cm*
- *Perfshin funksione cine me memorizim te shume cikleve mbi 28000 frame.*
- *Funksione automatike per permiresimin e rezolucionit, kontrastit dhe per rregullimin automatik te spektrit doppler (linja baze, frekuenca PRF, etj.)*
- *Shpejtesia maksimale e nderrimit te imazhit mbi 2600 frames/sec*
- *Shfaqja e imazhit: 2D-Mode, M-Mode, Color M Mode, Color Doppler, Poëer Doppler (PD), Pulse Èave Doppler (PÈD), 3D-Mode, 4D-Mode, Beam Steering, Harmonic Imaging.*
- *Color Doppler. Amplifikimderi ne 100dB. Perthyerje e kendit te skanimit ne te pakten 6 nivele dhe kend maksimal $\pm 20^\circ$. Mundesi selektimi deri ne 20 ose me shume harta ngjyre.*
- *Poëer Doppler. Amplifikimi deri ne 100 dB*
- *PÈ Spectral Doppler. Intervali i frekuences jo me pak se 0.3 – 25 KHz. Shpejtesia: 0.1 -1700 cm/s. Amplifikimi deri ne 100 dB.*
- *Softëare 3D dhe 4D. Paraqitje deri ne 3 plane X-Y-Z dhe imazhit 3D ne kohe reale (4D). Gjenerim me prerje terthore me distance te ndryshueshme nga 0.5mm deri ne 30 mm. Mundesi perpunimi te imazhit 3D, pastrim i artifakteve dhe rrotullim volumi deri ne 120° . Mbi 15 harta ngjyre 3D.*
- *Softëare per administrimin e te dhenave te pacienteve*
- *Softëare per permiresimin e kontureve te imazhit, diferenciminin dor dhe reduktimin e artifakteve*
- *Te kete filter per reduktimin e artifakteve me min. 5 shkallezime*
- *Perfshin Sondat:*
- *Sonde konvekse 2D, multifrekuence 1-6 MHz, Numri minimal i elementeve 128. Teknologji e avancuar per depertim dhe rezolucion maksimal(Single Crystal).*
- *Sonde lineare, multifrekuence 3-12 MHz, numri minimal I elementeve 192*
- *Sonde kardiake, multifrekuence 1-5 MHz*
- *Te kete memorje te brendshme HDD per te pakten 500 GB*
- *CD/DVD-RË te inkorporuar*
- *Te kete te pakten 6 porta USB 2.0.*
- *Pajisur me porte Ethernet dhe lidhje ÈiFi*
- *Video Printer Bardh e Zi*

3. Shtratit pacienti me dyshek

- Shtratit i pacientit duhet te jete i dizenuar ne menyre sa me ideale per monitorimin , kurimin, rehabilitimin e pacienteve ne spital
- Shtratit duhet te jete i paisur me 4 motore dhe te kete te gjitha pozicionet ulje, ngritje, trendelenburg
- Levizja e pjeses ballore dhe fundore te shtratit duhet te behet nepermjet elektromotoreve .
- Elektromotoret ne raste nderprerje elektriciteti duhet te funksionojne me ane te baterie 9V.
- Elektromotoret dhe mekanizmat e krevatit duhet te jene silencioz dhe pa dridhje.
- Pozicionimet dhe elektromotoret e shtratit duhet te kontrollohen nepermjet nje pulti qendror.
- Siperfaqja e shtratit duhet te jete i perbere nga kater pjese.
- Siperfaqja e shtratit e perbere nga kater pjese te jete e fiksuar me skeletin dhe te jete e lehte per tu pastruar, gjithashtu te kete vrima ne gjitha sferat per ajrimin e dyshekut.
- Pjeset ballore dhe fundore te shtratit te hiqen dhe te vendosen me lehtesi si per pastrim ashtu dhe per mirmbajtje, te jene njelloj me ngjyren e skeletit dhe te perbera nga material ABS(Acrylonitrile butadiene styrene).
- shtratit duhet te kete nga dy mbrojtese anesore nga te dyja anet qe mund te ulen dhe ngrihen nepermjet nje butoni ne menyre elektrike, duhet te levizin ne menyre te pavarur me njera tjetren dhe te jene ne ngjyre me skeletin te perbera nga material ABS(Acrylonitrile butadiene styrene).
- Shtratit duhet te jete i paisur ne anesore me mbajtset e qeseve te urines per pacientin.
- Trashesia e profileve te perdorura per ndertimin e skeletit te shtratit nuk duhet te jene me pak se 1.20mm.
- Levizjet e kembave te pacientit duhet te behen nepermjet elektromotoreve.
- Shtratit duhet te jete i paisur me kater rrota plastike ,silencioze, qe mund te rrotullohen 360 grade, dhe dy nga rrotat te jene te paisura me sistem frenimi.
- Shtratit duhet te jete i paisur me mbajttese serumi e cila duhet te jete e mundur te vendoset ne te kater cepat.
- Konstruksioni i shtratit duhet te jete i perbere nga celik i lyster me boje elektrostatische pluhur.
- shtratit duhet te kete garanci nje vjecare dhe te sigurohen pjeset e kembimit per nje periudhe 10 vjecare.
- Permasat e shtratit duhet te jene (GjxGjxL) 105x210x55-95cm
- Skeleti i shtratit duhet te jete i perbere nga profile box me permasa 50x30x1.2.
- Dysheku i shtratit duhet te perbehet nga kater pjese me sfungjer me densitet 22.
- Dysheku duhet te jete i mbeshjtelle nga material qe nuk percon lengjet trupore gjakun dhe te jete material antimikrobial.
- Dysheku duhet te kete permasat 90x190x15.
- Dysheku duhet te perputhet me te gjitha modelet e shtrereve spitalor.

8. Crush Cart(CAVS)/Mbajttese per Aparaturat dhe Paisjet e Emergences

- Skelet Mono-blok prodhuar ne polypropylene.
- 4 rrota antistatike 100 mm me frena
- 7 syrtare (3 cop me permasa 350 x 150 x 100 mm dhe 4 cop me permasa 350 x 150 x 75 mm)
- Rezervuari per frymemarrje artificiale : Revivator Plus per të rriturit me maske faciale N° 5 dhe rezervuar O2 dhe Revivator Plus për fëmijët me maske faciale N° 3
- Rezervuar 1L polikarbonati per aspirim
- Suport EN per mbledhesin e mbeturinave
- Mbledhes mbeturinash (I verdhe) 1 L.
- Bord masazhi kardiak
- Foldera per mbajtje e dokumentacionit

– etiketat per syrtaret

14. Poltrona kimioterapie:

- Poltroni i kimioterapise te jete komod dhe i rehatshem .
- te jete e perbere nga 3 pjesë ndenjesja, pjesa mbrapa dhe këmbët.
- Rregullimi i pozicionimit te shpines, këmbëve si dhe lartësisë së uljes e ngritjes te bëhet ne menyre elektrike
- Dysheku te jete i perbere nga sfungjer viscoelastik ne menyre qe te pershtatet me formen e trupit te pacientit si dhe te ule presionin mbi trup per terapi afatgjata
- Koka, pjesa mbrapa, pjesa e këmbës dhe e kraheve të hiqen dhe të vendosen lehtë për tu pastruar
- Poltroni te kete sistem diagonal frenash, i projektuar për fiksuar kur është e nevojshme.
- Struktura e poltronit te jete e lyer me boje elektrostatische per te parandaluar ndryshkjen dhe demtimin e skeletit te celikut si dhe te pastrohet me lehtësi .

– Dimensionet:

Gjatësia: 205 cm

Gjatësia e segmentit Mbrapa : 77 cm

Këndi i segmentit mbrapa : 0-75°

Gjatësia Min-Max: 59-79 cm

Gjatësia e ndenjeses : 50 cm

Gjatësia e segmentit te këmbës : 64.5 cm

Segmenti fiksuses i këmbës: 27,5 cm

Kendi i segmentit te këmbës : 0-35°

Pozicioni Trendelenburg: 0-34°

Pasha maksimale e sigurt: 200 kg

III.1.4. Sipas përgjigjes që autoriteti kontraktor i ka dhënë ankimesit, nëpërmjet shkresës nr. 1360/1 prot, datë 16.05.2018, është argumentuar si vijon:

“[...] Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se pretendimi i operatorit ekonomik “Farma Nat” sh.p.k nuk qëndron për arsye se:

Kriteri në të cilin përcaktohet dorëzimi i mostrave është plotësisht i bazuar në legjislacionin e prokurimeve publike në Republikën e Shqipërisë. Neni 27 “Kontrata e mallrave”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcakton se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentat e tenderit si: a) mostra e mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor.”

III.1.5. Në nenin 46 pika.1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.1.6. Në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të ndryshuar , neni 23 pika 1 dhe 2, përcaktohet se: "1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik".

III.1.7. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 27 "Kontratat e mallrave", pika 6 përcaktohet "Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike."

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

"2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifikë, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë:

(i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike (referuar nenit 12 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar” të kryerjes së verifikimeve (egzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor të mostrave të dorëzuara, në rast se, këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Ligjvënësi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit strictu sensu me rëndësinë që ka për vlerësimin e ofertës teknike. Sa më sipër, KPP gjykon se, në vlerësimin e proporcionalitetit të kërkesës së autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave për të gjithë produktet duhet parë në interpretim të zgjeruar me rëndësinë që ka dorëzimi i mostrave me vlerësimin e ofertës teknike. Në vlerësimin ligjor në rast se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor zë peshën më të madhe, rëndësinë më të madhe, apo pa plotësimin e këtij kushti, autoriteti kontraktor nuk mund të realizojë qëllimin e tij final në vlerësimin e ofertës teknike, KPP gjykon se duhet interpretuar në tërësi neni 27 pika 6 i VKM 914/2014.

III.1.10. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi. Për vlerësimin e ofertës teknike nga operatorët ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar një sërë dokumentacioni, duke nisur nga dorëzimi i autorizimit të prodhuesit, certifikatat që vërtetojnë se prodhuesi i produkteve është i çertifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO, katalogjet dhe garancinë për produktet e kërkuara. Me anë të dokumentacionit të mësipërm të kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor mund të investigojë, krahasojë në mënyrë të plotë mbi përputhshmërinë e produkteve të ofruara më ato të kërkuara. Duke marrë shkas nga natyra e mallrave të cilat kërkohet dorëzim i mostrave përkatëse nga ana e autoritetit kontraktor, KPP konstaton se, këto të fundit shfaqen në cilësinë e produktit final dhe asnjëherë të lëndës së parë për përfitimin e produktit final e njëherazi kontrolli më përpara (*ex-ante*) i përputhshmërisë së specifikimeve teknike me kërkesat e autoritetit kontraktor shfaqet i vështirë për tu realizuar dhe synimi i autoritetit kontraktor përmbushet edhe me anë të dokumentacionit të mësipërm të kërkuar nga ky i fundit (katalogjet/ skedat teknike/ apo skicat e prodhuesit/prodhuesve) me anë të cilave kontrollohet edhe përputhshmëria e specifikimeve teknike të produkteve të ofruara. Sa më sipër, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave të kërkuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa mbi dorëzimin e mostrave të sipërcituara nuk është e *rëndësishme* për vlerësimin e ofertës teknike në kuptim të nenit 27 pika 6 gërma “a” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.1.9. Akoma më tej, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit të dytë *pas lidhjes së kontratës* të përputhshmërisë së produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar, me ato të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”

të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet përkatëse duke hequr kriterin e mësipërm.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Farma Net” sh.p.k për procedurën e prokurimit Nr.REF-80415-07-24-2018 me objekt: “Blerje aparatura per Cath-Lab (reparti i Kardio-hemodinamikes) dhe poltrona, shtrat vizite etj per Kemio Terapi”, Loti 2, me fond limit limit 20.604.000 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar ne daten 03.09.2018 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Farma Net” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1379 Protokolli,

Datë 09.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha